

ZHVILLIMI EKONOMIK I HIMARES : POTENCIALET, SFIDAT & SUGJERIME PER RRITJEN E PROSPERITETIN E SAJ.

Prof. dr. Priamo BOLLANO

Konferenca e tanishme Panhimariote, e para ne llojin e vet, eshte thirrur per te analizuar e diskutuar, se bashku, disa nga problemet te nje rendesie te veçante per zhvillimin ekonomik e social te Himares, me rrezatim te veçante per te ardhmen. Kjo sepse Himara megjithese eshte nje “princeshe” e bukur ne brigjet e Jonit, ndodhet ende e pergjumur dhe pavarsisht nga perkundjet qe i bejne dallget e Jonit dhe zhurma e vetetimave te Akroqeraunes, ajo ende nuk eshte zgjuar dhe nuk ia ka marre kenges e valles shtruar, ashtu siç i ka hije, duke shpalosur me madheshti e krenari bukurite, talentet e gjithe madheshtne e saj.

VESTRIM I SHKURTER GJEOGRAFIKO-HISTORIK I HIMARES.

Himara eshte nje krahine qe shtrihet ne Shqiperine Jug-Perendimore. Ajo ben pjese ne treven qe njihet me emrin edhe si Bregu i Detit, nga jugu i Qafes se Llogarase, perendimi i Maleve te Çikes dhe vargut Konjak–Lavan. Lugina e lumit te Borshit e ndan Bregun e Detit ne dy pjese: Ne bregun e siperm ose Himaren dhe ne bregun e poshem. Ne teresi kjo treve per nga kushtet etnografike e gjeografike njihet edhe me emrin Riviera e Shqiperise.

Himara, ne teresi Bregu i Detit, eshte zona me e ngrohte e Shqiperise. Zgjatja e diellzimit ne te arrin 2500 ore ne vit, ndersa numri i diteve me diell eshte mbi 330. Temperatura mesatare vjetore eshte 17 grad. Ujrat jane te pakta, kryesisht burime nentoksore. Ato jane shfrytezuar nga banoret duart art te bregut, me nikoqirlek, per ujitjen dhe hidroenergji, permes hidrocentraleve te vegjel te ngritur ne Dhermi, Qeparo, Borsh dhe Bunec.

Himara laget nga deti Jon i cili dallohet per ujrat e tij shume te ngrohta. Temperatura mesatare e ujit ne Shkurt arrin ne 14 grade, kurse ne Gusht 25-26 grade. Permbajtja e kriperave arrin deri 39%. Gjate tere Bregut ne gjatesi mbi 100 km, ngrihen male me lartesi nga 800-2000 m, kryesisht nga formacione gurore. Proçesi i fuqishem tektonik dhe veprimi shkaterrues i dallgeve te detit, nder shekuj, kane krijuar nje vije bregdetare gjarperuese me shume gadishuj, kepa, gjij, lumenj e perrenj te bardhe, qe i japin krahines nje bukuri te rralle, me vlera te medha. Ne Bregdet gjenden shpella te medha ku gurgullon uji i detit, guva, gremina, ku shpatet bien thike mbi detin, plazhe zallore te vegjel e shume te bukur, qe karakterizohen nga shkelqimi gjithvjetor i diellit mesdhetar, nga uji i paster dhe i ftohte i burimeve, nga bukuria mahnitese e ujrave te kalterta e te tejdukshme te Jonit, ne sfondin blu te te cilit zbardhin vetem kreshtat e valeve, qe si ne nje gare sportive, vrapojne per te kapur njera-tjetren ne drejtim te bregut. Fare afer tyre shtrihen brezaret e gjelbert gjithvjetor, te ngritur me mund e djerse te shumte nga himariotet, ne te cilat kultivohen bimet subtropikale ullinjt, agrumet, hardhite dhe pemet e tjera frutore, ndersa jo shume larg ne rreze te maleve, rritet bimesia spontane, kryesisht makjet mesdhetare, siç jane sherebela, dafina,

valanidhie deri tek druret e rralle per gjithë vendin, e qe rriten vetem ne bregun e Detit si xhixhibanozi, pambuku i eger, euforbia, bananet, lulja e mentes, bocka, fiqte e hindit etj.

Himara e sotme e ka emrin e saj nga nje vendbanim i lashte i Kaonise qe deshmohet qe nga shekulli V p.e.r. me emrin Chimera. Shtrirja teritoriale e Himares ne rrjedhen e shekujve historikisht ka ndryshuar. Ajo eshte ngjeshur, tkurrur dhe rrudhur deri ne shtrirjen e sotme, qe perfshin fshatrat nga Palasa ne Qeparo dhe qytetin me te njejtin emer-Himare.

Burimet arkeologjike deshmojne qe si autoktone, ne trojet e veta, himariotet jane dalluar per qendrese te gjate kunder pushtesve dhe kunder padrejtesive shoqerore e demokratike. Jane te njojtura nder shekuj kryengritjet e shumta kunder osmaneve, nepermjet te cilave himariotet me 1492, e detyruan Sulltan Bajazitin e II-te, tu njihte privilegjet qe njihen dhe si venome siç jane: e drejta e pronesise dhe e qeverisjes se vendit ne baze te kanuneve tradicionale, e drejta per te pasur nepunes e gjyqje, mbajtja lirisht e flamurit, e armeve etj. te cilat jane ruajtur deri ne vitet e voneshme. Gjithashtu njihen perpjekjet e ndryshme demokratike, qe zhvillon sot populli i Himares per vendosjen e demokracise, shtetit ligjor dhe zbatimin e respektimin e te drejtave te njeriut etj.

PANORAME E ZHVILLIMIT TE SOTEM SOCIAL EKONOMIK TE HIMARES

Himara dhe i gjithë Bregu i Detit, sidomos keto 15-vitet te demokracise, pa dhe shijoi shume gjera. Ajo pa dhe shijoi ashpersine e konkurrences, riskun shkaterrues te saj, sikurse pa dhe ndjeu mundesite e shumta per prosperitet qe çel ekonomia e lire e tregut, forcen shkaterruese qe mbarti e ashtuquajtura “Terapia e shokut” e deri tek nderhyrjet me vend e pa vend te institucioneve publike ne inisiativen e lire private; shkaterrimet qe mbarti kriza e piramidave e deri tek kriza e sotme energjitike qe paralizoi ekonomikisht biznesin dhe çdo lloj tjetër veprimtari ekonomike. Himarioti gjate kesaj periudhe u be deshmitar i shkaterrimeve te shumta dhe i dhunimeve qe behen çdo dite mbi pronat, si dhe te shfaqjes e gjallerimit te disa dukurive dhe prirjeve shume te rrezikshme qe bien ndesh me natyren, shpirtin dhe karakterin e tij, te cilat per nje pellembe toke per nje ledh, ose per nje rrenje ullinj, mund te çojne ne gjakderdhje e dukuri te tjera masive te padeshirueshme.

Sot Himarioti, ne teresine e tij, vuan, shqetesohet dhe ndrydhet per kushtet e veshтира e jo te qarta ne te cilat ndodhet e jeton, per pasojat sociale ekonomike dhe rrisite e ndryshme shkaterruese qe mbart mosdisponimi prej tij i pronave sipas trashegimise, nga emigrimi masiv i pjeses me te madhe te popullsisë, si rezultat i mungeses se alternativave dhe strategjive te zhvillimit per te ardhmen, nga mungesa e drites jeshile, per te pare edhe Himarioti perspektiven me optimizem dhe kryelartesi tradicionale e patriotike.

Ne kete kontekst shtrohet pyetja: Cila eshte gjendja e tanishme ekonomike dhe çfare perespektiva shtrohen per zhvillimin ekonomik te Himares?

Pergjigjen e kesaj do te mundohemi ta japim duke analizuar Himaren dhe popullsine e saj, ne dy pamje kryesore: se pari si komunitet ose shoqeri konsumi, se dyti si komunitet ose shoqeri prodhimi.

Si komunitet konsumi, qe lidhet me nivelin dhe menyren e jeteses, Himara paraqitet sot ne standartet qe do ta kishin zili jo vetem zonat per rreth, por dhe me tutje. Kjo eshte rezultat i punes, kultures, tradites dhe menyres se jeteses se himariotit, te kultivuara e te trashaguara nga thellesia e shekujve. Per kete le te permendim se te gjitha fshatrat e Himares, per nga arkitektura e ndertimit, konceptimit, tradita dhe vlerat kulturore e urbane qe mbartin, paraqiten dhe jane me te vertete qytete te vegjel, qe mahnitin çdo vizitor vendas ose te huaj, qe ka rastin te njihet nga afer me to.

Ne mungese te te dhenave zyrtare per standartin e jeteses se popullit himariot, por bazuar ne vrojtimet dhe anketimet me zgjedhje te kryera prej nesh, si dhe bazuar ne menyren e jeteses e ne traditen e te ushqyerit te popullit himariot, ne menyren specifike mesdhetare te gatimit, ne kushtet e banimit dhe mallrat kryesore me origjine te paster natyrore e shtazore qe konsumon ai, ne shkallen e arsimit dhe aftesite punedhenese te tij, del se mesatarisht per fryme te popullsise himarioti shpenzon sot 13 deri 14 mije leke ne muaj. Ky nivel konsumi i arritur nuk ka asnje krahasim me te kaluaren, sidomos po te kemi parasysh ate çfare konsumonte himarioti gjate regjimit monist. Nderkohe bazuar ne kete tregues te rendesishem, nuk mund te themi se gjendja ekonomike e zhvillimit te Himares sot eshte e mire ose shume e mire.

Ne rast se dote arsyetohet keshtu do te behej gabim. Prandaj, per vleresimin real te gjendjes se zhvillimit ekonomik te Himares, analizat ne aspektin material te konsumit kerkohet te krahasohen me treguesit qe karakterizojne Himaren si komunitet prodhimi. Kjo do te thote se çfare konsumon himarioti sot, duhet te ballafaqohet me burimet e formimit te te ardhurave qe disponon ai per plotsimin e nevojave te veta.

Analizat, vrojtimet dhe perpunimi i te dhenave per Himaren si komunitet prodhimi tregojne se treguesit nuk dallohen shume nga ecuria e pergjithshme e mbare Shqiperise ose e krahinave te veçanta te saj. Llogaritjet e bera mbeshtetur ne vrojtimet dhe anketimet e kryera na lejojne te arrijme ne perfundimin se te ardhurat qe vijne nga aktiviteti i brendeshem ekonomik ne Himare (d.m.th. nga puna ne sektorin privat si fermer ose biznesmen, ne sektorin publik dhe te ardhurat nga pensionet, nga ndihmat ekonomike dhe te ardhurat nga ekonomia informale), jane ne madhesi te atille qe nuk mbulojne konsumin per fryme ne aspektin material. Mesatarisht gjate nje muaji, himarioti ka ne dore nga aktivitetet ekonomike te zhvilluara brenda krahines, rreth 7 mije leke, ose mbi 2 dollare per fryme ne dite. Mbeshtetur vetem ne kete tregues mund te theksojme me plot te drejte se popullsia e krahines ndodhet diçka me shume se te kufiri i varferise, pasi te ardhurat që sigurohen ne vend jane me te vogla se kufiri i domosdoshem i minimumit jetik. Ne nxerrjen e ketij perfundimi mbeshtetemi ne ate, se sipas OKB-se ne popullsine e varfer perfshihen ato grupe te popullsise te cilat sigurojne te ardhura ditore me pak se 2 dollare dhe ne popullsine shume te varfer ato qe sigurojne me pak se 1 dollare te ardhura ne dite.

Pra me te ardhurat financiare te krijuara brenda krahines himarioti eshte ne gjendje te perballoje 50% te konsumit te tij material mujor. Pjesa tjeter perballohet nga te ardhurat qe i vijne atij nga burimet jashte krahines, ose nga te ashtuquajturat transfertat e fondeve. Keto transferta megjithese nuk prodhohen dhe nuk krijohen ne Himare, konsumohen dhe shpenzohen ne Himare. Si te tilla lozin nje rol te pazevendesueshem ne zhvillimin e jetes, kultures dhe te çdo lloj veprimtarie ekonomike ne krahine. Ne pjesen dermuese transfertat jane te ardhura qe vijne nga emigrimi i popullsisë himariote jashte krahines, brenda dhe sidomos jashte Shqiperise. Ne kete kuader dergesat e emigranteve ndikojne efektivisht ne zbutjen e varferise dhe ne stabilizimin ekonomik te krahines, sherbejne gjithahtu edhe si burim kapitali per investime dhe zgjerimin e veprimtarive ekzistuese, pra s per hapjen e veprimtarive te reja.

Sigurisht kjo gjendje e zhvillimit ekonomik te Himares, qe ne menyre te sintetizuar shprehet ne nivelin e te ardhurave financiare per fryme te krijuara brenda krahines, nuk kenaq askend dhe as qe mund te konsiderohet si niveli i mire i arritur. Ajo eshte rrjedhoje e faktoreve te shumte ekzogjene e qe nuk mvaren nga himarioti. Ky perfundim behet me bindes ne rast se duke vazhduar logjiken ekonomike, krahasojme nivelin e arritur te te ardhurave me mundesite potenciale dhe sfidat qe shtrohen per zhvillimin ne te ardhmen e Himares.

POTENCIALE DHE SFIDAT E ZHVILLIMIT PER TE ARDHMEN E HIMARES

Natyra dhe shtrirja gjeografike e Himares, krahas bukurise se rralle dhe mahnitese i ka fale dhe i ka dhene njekohesisht asaj mundesi te shumta potenciale zhvillimi, shfrytezimi racional i te cilave do ta shpinin shume perpara rritjen e prosperitetin ekonomik dhe social te himariotit. Le te analizojme shkurtimisht faktoret e zhvillimit ekonomik te krahines.

Burimet natyrore ose tokes dhe shtrirja gjeografike e krahines perben faktorin vendimtar baze te zhvillimit. Per Himaren dhe trevat per reth saj burimet natyrore jane mjaft te begata per nje zhvillim te pershpejtuar e te plote ne kuptimin bashkohor te ketij termi .

Ashtu sic eshte treguar ne teresi kursimtare ndaj ujit dhe ndaj tokave buqesore te karakterit fushor, ndaj burimeve te tjera natyra eshte terguar shume bujare. Ato jane te atilla qe lejojne zhvillimin, ne rradhe te pare, te turizmit dhe te agro-biznesit me prodhimet e vecanta buqesore e blektorale, sic jane ulliri dhe vaji i tij, agrumet, vreshtaria ne teresi fruti kultura me dardhat, pjeshket dhe fiqte karakteristik te bregut, mirerritjen e zhvillimin e blektorise e sidomos e te imtave, te bleteve , etj .

Nder kohe burimet natyrore dhe klima e Himares favorizojne kultivimin e zhvillimin e flores spontane me vlere te madhe ekonomike, siç jane bimet eterevajore, sherebela, valanidhi, rigoni çaji i malit, qepa e detit, dafina, lulja e mentes etj. Klima e krahines e karakterit mesdhetar si dhe deti me peisazhe e gjij te mrekuallueshme jane te

atille, qe lejojne zhvillimin ne shkalle te gjere te turizmit, pothuajse ne te kater stinet e vitit .

Aktualisht potencialet e mundshme per zhvillim qe posedon Himara jane ose ne hapat e para te shfrytezimit, ose ndodhen ende ne gjendje latente. Me perjashtim te disa lokaleve e ngrehinave turistike dhe te biznesit te ndertuara spontanisht me mund e shume djerse nga sipermarres “privat himariot”, pa asnje lloj perkrahjeje dhe jashte kriterëve te shendosha ekonomike e te menaxhimit, ekologjik e te infrastruktures, qe perdoren per turizem kryesisht nje deri nje muaj e gjysme ne vit, burimet e tjera natyrore i jane lene meshires se fatit, shfrytezohen pothuajse ne menyre ekstensive-natyrore.

Sot ulla njete agrumet dhe pemet e tjera frutore, te ngritura me mund e djerse ne brezare shekullore nga stergjysherit, gjysherit dhe baballaret tane, ndodhen pothuajse ne nje gjendje zhvillimi natyror, te eger e spontan. Gjate ketyre 15 viteve te fundit pervec se eshte shkaterruar e gjithë infrastruktura e sherbimit te tyre (eshte prishur rrjeti vadites, mungesa e mekanikes bujqesore etj), me perjashtim te punes se paket qe behet per vjeljen dhe grumbullimin e atij prodhimi qe bima jep fale ligjeve natyrore te riprodhimit te saj, asnje sherbim tjetër nuk u behet.

Nga ana tjetër, burimet natyrore te pakultivuara dhe qe lidhen me shfrytezimin e flores spontane, si te valanidhit, sherebeles, qepes se detit etj. jane larg vemendjes e kujdesit të njeriut, në një kohë kur vitet e shkuara që zënë fill nga vitet 20 të shekullit të kaluar, të gjitha këto grumbulloheshin, përpunoheshin dhe eksportoheshin, ndërsa sot shpërdorohen duke shkuar dëm një pasuri e madhe që nuk rinovohet. Të ardhurat që nuk realizojmë sot nga kjo pasuri nuk mund të realizohen vitet e ardhshme.

Në këtë gjëndje të mjeruar ndikojnë shumë faktorë. Por themelore është ndikimi i faktorit që ka të bëjë me **mos zgjidhjen e drejtë të pronësisë mbi tokën**, bazuar mbi kriterin kushtetues të trashigimisë. Si rrjedhojë Himarjoti sot nuk disponon dokumenta që të vërtetojë pronësinë e tij, nuk është në gjëndje të veprojë me iniciativën dhe vullnetin e tij të lirë, në kushtet e ekonomisë së tregut, të blejë dhe të shese tokën, ta shkëmbejë atë lirisht në treg sikurse shkëmben çdo lloj malli tjetër. Përveç moszbatimit të kriterit të trashëgimisë mbi tokën këtë problem e kanë vështirësuar dhe e vështirësojnë së tepërmi edhe praktikatat korupsioniste, që janë ndjekur dhe po ndjekin institucionet perkatëse publike për rregjistrimin e pasurive të patundshme, praktikatat e shumta të shitblerjeve dhe të mbivendosjeve që kane zbatuar, në raste të veçanta pushtetarët e krahines dhe më tej. Ndërkohë ende nuk ekziston vullneti dhe dëshira për të zgjidhur drejt tokat që nën rregjimin totalitar komunist, ishin zaptuar arbitrarisht për ndërtimin e bazës ushtarake të Porto Palermos, të cilat edhe sot konsiderohen ambjente të pronës shtetërore, ashtu sikurse nuk bëhet asnjë fjalë për dëmshpërblimin e 55 pronarëve të trokallave (punishteve) të vajit, që u shtetëzuan pa pagesë nga diktatura dhe që pronarët i kanë pasur në përdorim para vitit 1939.

Lidhur me problemin e pasurive nga tribuna e Konferencës mbarëhimarjote mbështesim atë që Shoqata Atdhetare Bregdeti e ka trajtuar me kompetencë e në

gjerësi, se tokat në bregdet për vetë kushtet specifike të tij, duhen ndarë sipas **trashëgimisë, duke marë secili tokat e veta**. Shprehja “na e lini neve këtë punë” si shprehje e kufizimit të ndërhyrjes së shtetit në iniciativën dhe sipërmarjen e lirë private, të theksuar nga Smithi e Rikardoja, që janë edhe baballarët e ekonomisë politike klasike borgjeze, është sipas nesh shprehja që do ti përgjigjej më mirë veprimtarisë së institucioneve publike lidhur me pronësinë mbi tokën dhe në tërësi të burimeve natyrore në Himarë.

Ashtu sikurse jepen burimet natyrore, të gatshme nga natyra nuk mund të sigurojnë atë prosperitet e përparim që kërkohet për të plotësuar nevojat e gjithanshme të komunitetit himarjot. Prandaj kërkohet që mbi bazën e këtyre mundësive, duke investuar sa më shumë **punë njerëzore** të çelen perspektiva të reja zhvillimi dhe përparimi.

Në aspektin e burimeve të punës Himara sot është në mes të alternativave të ndryshme. Pjesa më e madhe e popullsisë aktive të saj është jashtë në emigracion. Kjo dukuri është rjedhojë e politikës abmicioze dhe shkatëruese që ndoqi për afro 50 vjet, edhe në Himarë, regjimi monist, i cili e ndrydhi shpirtin krijues e transformues të himarjotit, e mbajti atë të bllokuar dhe nuk e lejoi të shpaloste lirshëm aftësitë krijuese, të fluturonte “si zog në tramundane” siç thotë dhe kënga jonë. Prandaj Himara është sot një nga krahinat që e ka ndjerë dhe e ndjen deri në palcë fluksin shumë të rëndë të eksodit të krahut të punës dhe të familjeve të tëra himarjote.

Emigrimi në masë i krahut të punës krijon mundësi të mëdha për përvetësimin e teknikave dhe profesioneve të reja, për njohjen e përvojave të huaja përparimtare të punës dhe për grumbullimin e kapitaleve për të investuar në vendin e lindjes. Njëkohësisht ai ndikon negativisht në strukturën demografike të popullsisë në krahinën e Himarës dhe në plakjen e saj. Llogaritjet e kryera, bazuar në një anketim të kryer, tregojnë se në Himarë popullsia 65 vjet e lart përbën më shumë se 40% të popullsisë banuese kundrejt 7.5% dhe 8.7% që është ky tregues përkatësisht në shkallë republike, dhe në rrethin e Vlorës, pra janë shumë herë më të vogla. Po kështu edhe po tu referohemi publikimeve të INSTAT kjo grup moshe e popullsisë në Himarë është mbi 29%. Pra kemi një popullsi të plakur.

Por në kundërpeshë të mungesës të krahut të punës, si rrjedhojë e emigrimit, për përparimin e Himarës veprojnë: **së pari** karakteri dhe shpirti punëdashës i himarjotit, që “çfarë i sheh syri i bën dora” dhe **së dyti** pasja e një armate mjaft të madhe intelektualësh në të gjitha degët dhe dijet shkencore, që përbën një potencial të madh e të pazëvendësueshëm zhvillimi. Falë krenarisë që i japin malet e Vetëtimës që e rethojnë, kthjelltësisë dhe tejdukshmërisë që i jep deti Jon, falë dashurisë dhe etjes së madhe për kulturë dhe dije, Himara paraqitet me një potencial tepër të madh intelektual, që i llogaritur për frymë të popullsisë, ja kanë zilli shumë vende, të cilët qytetërimin e tyre e masin në shekuj. Le të përmendim vetëm faktin se deri në fillim të vitit 2000 numuroheshin afro 50 himarjotë me tituj dhe grada shkencore, pa përmendur këtu

shumë e shumë himarjotë të tjerë që mbajnë tituj të ndryshëm nderi “Heroi i Punës”, “Artist i Popullit ose i Merituar”, “Mësues i Popullit ose i Merituar” etj.

Këta faktorë dhe politikat strategjike të studjuara të aktivizimit të burimeve natyrore të krahinës, me një menaxhim të drejtë dhe objektiva të caktuara mirë të krahut të punës nga zona dhe krahina të tjera të vendit i shërbejnë zhvillimit e përparimit të Himarës. Megjithatë theksojmë se, themelorja e themeloreve edhe **në zgjidhjen e problemit të burimeve të punës në Himarë është zgjidhja e drejtë sipas parimit të trashëgimisë të problemit të pronësisë**. Edhe për këtë çështje ne përsëri mbajmë parasysh atë që kanë theksuar Smithi e Rikardoja se “ toka është nëna e begatisë ndërsa puna është babai i saj”. Le të bashkojmë pra tokën-nënë, me punën-babain-himarjotin punëtor dhe duar artë, dhe Himara do të ketë atë përparim e prosperitet që ndoshta edhe ëndërrtarët më optimistë të saj nuk do ta kishin parashikuar.

Ndërkohë zgjidhja e problemit të pronësisë mbi tokën e të çdo lloj pasurie tjetër të patundshme që kanë pasur himarjotët para viteve të luftës, do të shërbejë si një indikator i fuqishëm edhe për **kthimin e një pjese jo të vogël të himarjotëve nga emigracioni**, si dhe punësimin e më shumë forcave të punës nga krahina e zona të tjera për rreth Himarës. Mbi këtë bazë Himara do të mund të shndërohet në një trevë të zhvilluar me fronte të shumta pune dhe jo të kufizuara që ekzistojnë sot, e që me të ardhurat e krijuara do të mund të plotësohen nevojat imediate të popullsisë së saj, por edhe të krijojë burime kapitalesh për investime në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të saj, por edhe të krahinave për rreth e të mbarë vendit.

Faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e Himares **është kapitali**. Për ndertimin e lokaleve dhe ngrehinave, të turizmit bashkekohor, për ngritjen, zhvillimin e funksjonimin, e sipërmarrjes së lire dhe të fermave e komplekseve blektorale, për ushtrimin e cdo lloj biznesi ekonomik nevojiten kapitale të ndryshme financiare, në forme e aseteve të palujtshme por edhe të kapitalit Cash.

Për zhvillimin e përparimin e Himares me punë të kujdesshme dhe në mënyrë të sinkronizuar mund të gjenden kapitalet e nevojshme financiare përmes sigurimit të tyre nga mjaft drejtime e rrugë të ndryshme. **Se pari** ekziston vullneti e dëshira e mirë e himarioteve për të investuar portofolin dhe kapitalet e krijuara përmes kursimeve të ndryshme ashtu edhe përmes ushtrimit të sipërmarrjes së lire private. Biznesmenet dhe sipërmaresit e lire himariote që ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda ose jashtë Himares, përbejnë një forcë të madhe investitore. Nderkohe, nuk duhet larguar vëmendja edhe nga transfertat ose dergesat e fondeve nga emigrantet e shumtë të krahinës.

Është fakt se emigrantet himariote në shumicën e tyre mbajnë lidhje të vazhdueshme me familjet në Himarë. Ata ndjekin se afërmi zhvillimet e brendshme dhe presin me padurim krijimin e kushteve sa më të favorshme për investimin e portofolit të tyre në Himarë. Rol të vecantë u krijon atyre edhe zhvillimi i aktiviteteve të të dy bankave të cilat u lehtësojnë shumë format e transfertave të tyre e që ushtrojnë veprimtarinë në Himarë. Nga ana tjetër, prirja e disa prej tyre, për të ngritur biznese e sipërmarrje të lira në vendin ku ata ndodhen, ushtron ndikime pozitive jo vetëm në

drejtim te ritjes se transfertave si burim kapitali per investime ne Himare, por njekohesisht luan nje rol te madh pozitiv edhe ne krijimin e nje **klase biznesi te kualifikuar** e te pregatitur per te mare ne dore e çuar perpara prosperitetin e Himares, sapo ata do te mund te kthehen ne nje prespektive te afert ne atdhe.

Se dyti ekzistojne shume donatore dhe sponsorizues qe kane deshire dhe vullnet per te investuar ne kete krahine. Vendosja dhe konsolidimi i shtetit ligjor, zbatimi sa me i plote i legjislacionit shqiptar per te ashtuquajturat “zona te lira ekonomike” dhe “koncesionet”, si dhe stimulimet e ndryshme te inisjatives se tyre nga ana e Bashkise se Himares, brenda ligjit, normave dhe formave te lejuara, do te mund te favorizonin terheqjen e sa me shume kapitaleve te huaja per investime ne drejtim te perparimit e prosperitetit te Himares.

Se fundi, per nga radha por jo per nga rendesia, kryesorja e kryesoreve ne terheqjen e kapitaleve dhe sigurimin e tyre per sponsorizimin e zhvillimit te Himares mbetet **zgjidhja sipas kriterit kushtetues te trashegimise, te problemit te pronave**. Mardheniet e pronesise percaktojne gjithë mardheniet e tjera ekonomiko-shoqerore, qendrimet ndaj prones percaktojne edhe qendrimet ndaj iniciatives se lire. Zgjidhja e problemit te pronesise sherben si pike mbeshtetese ne zgjidhjen dhe gjetjen e burimeve financiare te nevojshme per sponsorizimin e kapitaleve per zhvillimin e Himares, nepermjet shit-blerjes se lire te pjeseve te saj, nga ana e pronareve te ligjshem, dhenies se saj me qera etj.

SUGJERIMET KRYESORE PER RRRITJEN EKONOMIKE TË HIMARËS

Problemet dhe sfidat që shtrohen për prosperitetin e Himarës dhe të krejt Bregut në tërësi na lejojnë të parashtrijmë sugjerimet kryesore që vijojnë:

1. Mbështetur në burimet natyrore, të punës dhe në terësi në faktorët e zhvillimit ekonomik, Himara paraqet një trevë ku **çdo lloj investimi dhe sponsorizimi i kapitaleve është shumë i leverdisshëm**. Kjo jo vetëm në aspektin e begatisë që i garanton popullit të Bregut, por edhe në aspektin e krijimit te burimeve financiare për zhvillimin edhe të krahinave e zonave të tjera. Llogaritjet tregojnë se afatet e vetshlyerjes së investimeve në Himarë janë shumë herë më të vogla në krahasim me ato që arrihen nga investimi i kapitaleve të kryera në krahina ose treva të tjera të vendit.

2. Në përparimin e zhvillimin e Himarës, kryesorja e kryesoreve mbetet **zgjidhja e problemit të pronësisë së patundshme që kanë pasur himarjotët para vitit 1945,** mbështetur në parimin kushtetues të trashëgimisë. Nga vajtja e pronës te pronari i ligjshëm do të marrë shkas edhe zgjidhja e problemit të krahut të punës si dhe zbutja e emigrimit, sigurimi i donatorëve vendas e të huaj për sponsorizimin e përparimit të Himarës.

3. Faktorët e begatë të zhvillimit që posedon Himara nuk mund të japin efektin e dëshiruar pa patur e ndërtuar **një infrastrukturë të zhvilluar**. Përvoja tashmë ka vërtetuar se krahinat dhe trevat që posedojnë një sistem koherrent komunikimi, një rrjet bashkëkohor bankar e shërbimesh socio-kulturore, një sistem të qëndrueshëm

energjitik dhe rrjet modern hidrik, janë shumë më të zhvilluara se krahinat apo trevat e tjera që nuk kanë këto mundësi. Le të theksojmë se OKB-ja për të përcaktuar shkallën e zhvillimit ekonomik të një vendi, apo rajoni, mban parasysh ndër të tjera dhe sasinë e energjisë elektrike të konsumuar për frymë të popullsisë. Në aspektin e elementëve të infrastrukturës mbetet shumë për të bërë në Himarë.

4. Rol në zhvillimin e përparimin në të ardhmen e Himarës do të kishte përqëndrimi më të madh i vëmëndjes së institucioneve publike, në drejtim të **restaurimit e vënjes në funksionim, në interes të turizmit kulturor, të monumenteve dhe veprave të tjera të traditës, që për nga numuri dhe rëndësia e tyre, Himara ka jo pak**, siç janë Kalaja e Himarës dhe ajo e Palermos, disa ndërtesa të stilit dalmato-venecian në Himarë, Vuno etj., kisha edhe objekte të shumta kulturi që gjënden me shumicë në të gjithë fshatrat. Në këtë kuadër do të ishte me interes përpjekja për shpalljen e gjithë Krahinës ose të fshatrave të veçanta të saj, si fshatra kulturore europiane, duke patur dhe mbështetjen e UNESCO-s, sikurse do të kishte shumë interes ngritja në qëndër të Himarës të bustit të “Vajzës të valëvë” etj.

5. Si në shkallën e gjith vendit edhe për banoret e Himarës do të ishte e dobishme **hartimi dhe zbatimi i strategjive dhe politikave sociale**. Kështu, në vend që të zbatohen, siç ngjet dhe sot, politika egalitariste ose e rrafshimit të qytetarëve për efekt të pagimit të taksave, të mbahet mirë parasysh parimi i përfitimit ose i aftësisë paguese, që qëndrojnë në themel të një politike sociale fiskale. Duhet patur parasysh fakti, se nga pagesa e taksave, qoftë edhe disi të rritura, popullsisë me të ardhura mesatare ose të larta, i mohohet mundësia e konsumit vetëm e disa mallrave të tepërta ose luksi, ndërsa popullsisë me të ardhurat e ulta, përmes taksave i mohohet konsumi i mallrave më të domozdoshme të jetës së saj.

6. Duke marrë parasysh shtrirjen dhe konfiguracionin gjeografik të krahinës, largësinë e fshatrave nga qendrat urbane, ku ushtrojnë veprimtarinë institucionet publike si ato fiskale e tatimore, të rregjistrimit të pasurisë së patundshme, institucionet juridike etj., do të kishte interes edhe në kuadrin e decentralizimit të këtyre funksioneve, riorganizimi administrativ të Himarës, ose në rastin tjetër, ngritja e agjensive dhe të zyrave të tyre në Himarë, për të qënë sa më afër dhe për t'i shërbyer sa më mirë popullit.

7. Mbi bazën e përdorimit të bashkërenduar të faktorëve të zhvillimit, janë mundësitë që në një të ardhme jo shumë të largët, gjëndja dhe pamja e zhvillimit ekonomik të Himarës të ndryshojë. Llogaritjet tregojnë se në një prespektivë afat mesëm të ardhurat për frymë të krijuara në Himarë mund të mbrijnë në 18 mijë lekë në muaj ose 150 euro për frymë me një rritje ndaj nivelit të tanishëm prej 170%.

Në këtë nivel të ardhurash vendin kryesor do ta zënë të ardhurat nga turizmi dhe sipërmarja e lirë ekonomike joagrarë. Këto do të japin afro 80% të tyre. Në të njëjtën kohë, të ardhurat nga sipërmarja ekonomike me karakter bujqësor do të rriten kundrejt gjëndjes së tanishme 3 herë dhe do të përfaqësojnë jo më shumë se 20% të të ardhurave gjithësej që do të krijohen në krahinë. Një strukturë e tillë të ardhurash është në

perputhje të plotë me kushtet e veçanta specifike dhe potencialet që ofron Himara dhe është diametralisht e kundërt me strukturën e të ardhurave që realizonte Himara dhe Bregu i Detit gjatë regjimit monist, në sajë të politikave thellësisht agrare që zbatoi ai për më shumë se 50 vjet.

*

* *

Në mënyrë figurative Himara i ngjan dhe është një buqetë shumëngjyrëshe me lule. Secili prej nesh, bashkë me familjet tona, jemi pjesë e kësaj buqete. Të gjithë së toku përbëjmë atë që quhet Himarë. Freskia dhe lulëzimi i buqetës varet shumë nga freskia dhe gjallëria e çdo luleje. Prandaj edhe zhvillimi e përparimi i Himarës, i kësaj “Lule Vilajeti” varet shumë nga ne, kryesisht nga puna dhe përpjekjet tona veç e veç, dhe të përbashkëta ne interes të zhvillimit të Himarës.

Në këtë mision të rëndësishëm ndihmesë të veçantë u takon të luajnë **intelektualët** e krahinës dhe Shoqata e Pavarur e tyre. U perket atyre të parashtrajnë e të bejnë prezent para institucioneve publike shqetësimet dhe problemet e krahinës, të projektojnë e të hartojnë strategjira të ndryshme zhvillimi, për të ndryshuar gjëndjen e tanishme dhe konturuar të ardhmen e saj.

Njëkohësisht në këtë mision ndihmesë të veçantë u takon të japin **biznesmenët** e suksesshëm himarjotë, që fatmirësisht nuk janë të pakët në numur dhe që zhvillojnë sipërmarrjen e lirë private brënda ose jashtë Himarës, sepse ata posedojnë dhe kapitale të nevojshme. Per aktivizimin e tyre me iniciator kërkohet të jetë **Komuniteti Himarjot**, si pjese e shoqërisë civile, për t’i bindur ata dhe insistuar pranë institucioneve publike, për tu krijuar kushte lehtësuese, që para se të investojnë kapitalet e tyre në krahina ose treva të tjera, t’i investojnë në Himarë. Ndërkohë bashkia e Himarës me prioritet duhet t’u hapë driten jeshile, si dhe të zbatojë favore e kushte lehtësuese të njohura në **interes të investimit të kapitaleve për përparimin dhe prosperitetin e Himarës**. Në kushte të barabarta, ata kurdoherë duhet të gëzojnë përparësi ndaj sipërmarrëseve të tjerë.

Kjo do të ishte edhe rruga me e drejtë, me e mirë dhe më me interes për Himarën dhe popullin e saj. Njëherësh kjo do të ishte dhe kryerja e misjonit të brezit tonë ndaj brezave të ardhshëm, mbasi heshtja ose qëndrimi jonë inaktiv sot, do të ishte i pafalshëm dhe shume i dënueshëm nga brezat që do të vijnë. Për të mos qënë viktimë të historisë le të veprojmë sot pa humbur kohë.

Ndërkohë që Himara gjëndet sot në një “gjumë të tejzgjatur”, pamvarëssht nga potencialet e shumta që ajo disponon, e gjithë kjo nuk është faji i himariotëve as dhe i mungesës se deshires së tyre për t’a parë Himarën “Zonjë” dhe “Princeshë” buzë Jonit. Në të kundërtën, është faji i partive dhe i forcave politike që kanë qeverisur e drejtuar vendin, gjatë rrjedhjes së viteve. Është fakt se ata asnjëherë nuk kanë menduar dhe nuk kanë hedhur sytë serjozisht ndaj Himarës dhe Bregut të Detit, përveçse në rastet kur u janë dashur votat e himarjotëve.

Le të shpresojmë më në fund se gjykimet, qëndrimet dhe kohrat për Himarën,

ashtu sikurse për mbarë vendin, do të ndryshojnë. Edhe Himarën këtë perlë e margaritar, me siguri do ta presë një e ardhme e bukur dhe e begatë.

PERMBLEDHJE

Himara është një krahinë që shtrihet në Shqipëri jug-perëndimore. Njihet edhe si Bregu i Detit i sipërm dhe Riviera e Shqipërisë. Emri i saj rrjedh nga një vendbanim i hershëm i Kaonisë, i njohur që nga shekulli V, me emrin Himaera. Si autoktone në trojet e tyre, himariotët janë dalluar për qëndrime shekullore kundër pushtesve dhe kundër padrejtësive, për vendosjen e shtetit ligjor, dhe zbatimin e lirive dhe të drejtave demokratike.

Megjithatë kushtet e mira natyrore, klimatike dhe ekologjike Himara, ende nuk ka marrë atë zhvillim që duhet. Sot, himarioti konsumon të mira materiale për rreth 13-14 mijë leke ose rreth 110 euro për frymë në muaj, dhe nuk kanë asnjë krahasim me atë çka konsumonte në kushtet e rregjimit monist. Nderkohe, për blerjen e tyre, himarioti ka në dispozicion të ardhura të krijuara në krahinë afro 7 mijë leke ose diçka më shumë se 2 dollarë në ditë për frymë. Pjesa tjetër prej afro 50% e konsumit mbulohet nga transfertat, d.m.th. nga të ardhurat monetare, që realizohen jashtë krahinës por që konsumohen brenda saj.

Mbeshtetur në faktoret e prodhimit dhe potencialet e shumta që posedon Himara, për zhvillim, janë mundësitë që të realizohen mbi 18 mijë leke ose 150 euro për frymë në muaj. Që këto nuk janë shëndërruar në realitet kanë ndikuar se toku një sërë faktorësh eksogjenë, që nuk varen nga himarioti, siç janë: mos zgjidhja e problemit të pronësive së patundshme sipas parimit të trashëgimisë, eksodi në masë i krahut të punës, i cili ndër të tjera ka shtremberuar edhe strukturën demografike të popullsisë, mos inkurajimi i donatoreve vendas dhe të huaj për sponsorizimin e investimit të portofolit në interes të përparimit të Himarës, mos zbatimi i ligjeshmerisë “për zonat e lira ekonomike” dhe “për koncesionet” që do të ndihmonin investimet e huaja përparimin e prosperitetin e krahinës, mos inkurajimi dhe mos zbatimi i masave favorizuese ndaj biznesmeneve vendas për të investuar burimet e tyre financiare në radhë të parë në Himarë, mungesa e elementeve të duhur të infrastrukurës së nevojshme etj.

Himara është një buqete shumëngjyreshe lulësh, ku të gjithë himariotët së bashku përbejnë atë që quhet Himarë-“Lulja e Vilajetit”. Për zhvillimin dhe prosperitetin e saj kerkohet puna veç e veç dhe e bashkuar e himarioteve, pavarësisht nga vendi i punës dhe i banimit. Vetëm me një konsensus të plotë, duke realizuar partneritetin social të të gjithë subjekteve politike dhe ekonomike, të organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile, do të mund të arrihet ai zhvillim e përparim i Himarës të cilin do të mund ta kishin zili të gjithë që edhe endrimtarët me kurajoze nuk do ta kishin parashikuar. Vetëm kështu do të mund të kryenim edhe misionin tonë ndaj brezave të ardhshëm.